

V E N D I M
Nr.100, datë 31.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 30.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.110 Akti që i përket:

KËRKUES:MARK KRROQI, përfaqësuar nga avokat Bujar Hoti.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1.LEKË ÇUKAJ

2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj, me autorizim.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE Nr.2, përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.203, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja e pavlefshme e votimeve të datës 22.7.2001 në qendrat e votimit nr.5 Abat; Nr.7 Nikaj; Nr.9 Menmavriq; Nr.14 Prekal, Nr.6 Benë dhe Nr.9 Toplan të zonës zgjedhore nr.2.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuarit dhe të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.203, datë 25.7.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.2, duke njohur si fitues kandidatin për deputet zotin Lekë Çukaj, përfaqësues i Partisë Socialiste.

Kërkuari Mark Krraqi kërkon shfuqizimin e këtij vendimi dhe shpalljen të pavlefshëm të rezultatit në 6 qendra votimi, sipas objektit të kërkesës, me pretendimin se në to nuk është zhvilluar votimi. Për të argumentuar këtë pretendim të tij, kërkuari paraqiti disa procesverbale e deklarata, sipas të cilave në gjashtë qendrat e përmendura nuk është zhvilluar fare votimi.

Por sipas tabelave të rezultateve që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe atyre të paraqitura nga subjekti i interesuar, rezulton se vetëm në qendrën e votimit të fshatit Toplan nuk janë zhvilluar votime, ndërsa në pesë qendrat e tjera të pretenduara votimet janë kryer dhe janë plotësuar tabelat e rezultateve. Mbi këtë bazë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtar.

Në këto rrethana, përderisa ekzistojnë dokumente të rregullta që vërtetojnë zhvillimin e votimeve dhe nxjerrjen e rezultatit në këto qendra votimi dhe se moskryerja e votimeve vetëm në një qendër votimi nuk ndikon në rezultatin përfundimtar, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor dhe të neneve 26, 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.